



Obiliq, më 22.07.2020

№: X-434

Data 22.07.2020
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



DREJTORIA E ARSIMIT

Bazuar në nenin 8, paragrafi 1 dhe 2, të Ligji i Punës, nr.03/L -212, neni 5, paragrafi c, Ligji për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, neni 35, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr.04/L-032, Udhëzimet Administrative të MASHT-it, nr.15/2019, nr.17/2009, dhe nr.07/2017 rregullimi i procedurave në sektorin publik, Drejtoria e Arsimit me datë 22/07/2020, shpallë:

KONKURS

(Për plotësimin e vendeve të punës)

SHMLP "ISMAIL DUMOSHI" në Obiliq

- Një mësimdhënës për lëndën Gjuhë dhe Letërsi Shqipe me 18orë (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
- Një mësimdhënës për lëndët e përgjithshme të Ekonomisë me 10orë (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
- Një mësimdhënës për lëndën e matematikës.

SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova" në Obiliq

- Dy mësues klase (me kontratë një vjeçare) në Obiliq.
- Një mësues klase (me kontratë një vjeçare) në PNF në fshatin Mazgit i Epërm.
- Dy mësues klase (zëvendësim i pushimit të lehonisë) në Obiliq .

SHFMU "Migjeni" në Siboc

- Një mësues klase në PNF Graboc i Epërm.
- Një mësues klase, (zëvendësim i pushimit të lehonisë).
- Një punëtor teknik në PNF Graboc i Epërm.

SHFMU "Naim Frashëri" Breznicë

- Një arsimtar për Gjuhë Shqipe me 19orë (zëvendësim i pushimit të lehonisë) në PNF Kozaricë

SHFMU "Pandeli Sotiri" në Obiliq i Vjetër

- Një edukatore, (zëvendësim i pushimit të lehonisë).

SHFMU "Hasan Prishtina" në Milloshevë

- Një arsimtar të matematikës me 12orë (8orë në SHFMU "Hasan Prishtina" dhe 4orë në SHFMU "Fazli Grajqevci" në Hade).



Kushtet për mësimdhënës:

Kërkohet kualifikimi profesional përkatës, sipas Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ (MASHT), nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional Të Arsimit Të Përgjithshëm.

Kandidatët që konkurrojnë për mësimdhënës duhet ta sjellin:

- Diplomën së fakultetit të vërtetuar apo noterizuar (kopje),
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën e lindjes,
- Letërnjoftimin (kopje).
- Certificate nën hetime

Kandidatët, që konkurrojnë për këto vende të punës, të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk i kanë diplomat e nostrifikuara në MASH nuk do të përfshihen në listën e ngushtë.

Kushtet dhe kriteret për punëtor teknik:

- Diplomën e shkollës së mesme
- Certifikatën e lindjes
- Certifikatën nën hetime
- Letërnjoftimin (kopje)

Për të gjitha vendet e punës fletëkërkesat merren në Zyrën e Pranimit të KK-së, apo në faqen zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumentet të kompletuara në të njëjtën zyrë. Kandidatët do të ftohen në intervistë përmes telefonit.

Afati i konkursit është 15 ditë nga dita e publikimit në shtyp dhe te faqja zyrtare e komunës.

Rexhep Zeka
Drejtor i DA-së

